4864400	Det.Prap. Investime	29,932,973.79		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	9,240,760.24		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	41,643,366.41	534,100,181	7.80%

Detyrime pushteti qendror	Llogaria ekonomike	Vlera ne leke
Ministri linje (GR.06)	4864400	376,478,445.37
Ministri linje (GR.11)	4864400	1,489,937.00
FSHZH		
Fonde nga Rindertimi		
Shuma Ministri Linje		377,968,382.37

BASHKIA DI VJAKË / KËSHILLI I QARKUT FIER

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Periudha Janar-Prill 2024

në lekë

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	52,719,645	260,000,000
1	Taksat e veta vendore	18,857,195	99,197,000
a.	Taksa mbi pasurinë	15,703,383	74,658,000
b.	Biznesi i vogël	0	1,930,000
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	2,996,662	22,000,000
d.	Taksa të tjera vendore	157,450	609,000
2	Të ardhura jotatimore	26,562,606	85,011,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	12,166,000	38,446,000
b.	Tarifa administrative	6,343,676	20,631,000
c.	Të tjera jo tatimore	8,052,930	25,934,000
3	Taksa të ndara	7,299,844	75,792,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	0	440,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	6,075,328	17,300,000
c.	Renta minerare	0	0
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	839,716	10,000,000
e.	Të tjera	384,800	48,052,000
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	148,593,551	932,441,970
1	Shpenzime Korrente	137,875,151	622,910,410
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	95,124,786	319,893,210
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	15,811,109	52,290,900
d.	Shpenzime Operative	26,069,256	230,118,300
e.	Të tjera korrente	870,000	20,608,000
2	Shpenzime Kapitale	10,718,400	309,531,560
3	Burimet e Financimit	148,593,551	933,326,596
a.	Të ardhurat e veta vendore	30,262,524	284,383,350
b.	Transferta e pakushtezuar	79,367,051	372,196,900
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtëzuar sektoriale	38,963,976	275,861,720
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		884,626
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

OBJEKTI: DREJTORIA E BUJQËSISË, MJEDISIT, VETERINARISË DHE PYJEVE

Drejtoria e Bujqësisë : Sektori veterinarisë, agronomis dhe mjedisit dhe sektori pyjeve dhe kullotave, për periudhën Janar – Prill 2024 është në zbatim të objektivave dhe programit vjetor të hartuar në fillim të vitit të cilat janë :

1. Në krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit në bujqësi dhe blegtori dhe dhënien e asistencës teknike fermerëve.
2. Në administrimin dhe mirëmbajten e tokës bujqësore dhe resurseve të tjera.
3. Në krijimin dhe administrimin e sistemeve vendore mbështetëse të granteve për bujqësinë dhe blegtorinë.
4. Në mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe të njerzëve, në rritjen e sigurisë së ushqimit për produktet bujqësore dhe blegtoriale.
5. Në mbrojtjen e menaxhimit të pyjeve, në zhvillimin, administrimin e fondit pyjor
6. Në mbrojtjen e natyrës dhe administrimin e mjedisit.

NË BUJQËSI

Puna për vitin 2024 është përqendruar në realizimin e aktiviteteve të shërbimit këshillimor në bujqësi e blegtorinë përputhje me prioritetet dhe tendencat e bujqësisë në Bashkinë Divjakë, në zbatim të objektivave dhe politikave subvensioneve të MBZHR për këtë sektor. Objektivat e caktuara nga Drejtoria e Bujqësisë për sektorin e ekstesionit dhe këshillimi në bujqësi janë parashikuar në planet javore, mujore dhe vjetore.

1. Është kryer trajnimi i fermerëve në bazë njësie administrative dhe janë organizuar trajnime për:

- Mbjellja, kultivimi dhe trajtimi i perimeve në sera dhe në fushë të hapur.
- Mbjellja, kultivimi dhe trajtimi i bimëve të arave.
- Mbjellja, kultivimi dhe trajtimi i dru frutorëve, ullinjëve, vreshtave etj.
- Mbjellja, kultivimi dhe mbrojtja e bimëve foragjere.
- Njohja me politikat e përfitimit të subensioneve në bujqësi.

Janë organizuar seminarë me grup fermerësh në njësitë administrative Divjakë, Remas, Gradishtë, Tërbuf dhe Grabjan. Janë informuar fermerët për hartimin dhe zbatimin e teknologjive të reja në prodhim, duke bërë demonstrim në terren për metodat e kultivimit duke shpërndarë edhe fletëpalosje etj. Për mbrojtjen e bimëve janë rekomanduar:

- Preparatet e reja në qarkullim që disponon çdo fitofarmaci.
- Janë këshilluar fermerët për metodat e përdorimit të këtyre preparatëve.
- Janë njohur fermerët për afatet e karencës, për afatet e skadimit.
- Për teknikën e përdorimit.
- Për përqëndrimin dhe përgatitjen e solucionit dhe përdorimin e plehrave kristalore.
- Një rëndësi të veçantë i është kushtuar njohjes së fermerit me kultivaret dhe farerat e reja që janë në qarkullim
- Për përdorimin dhe teknikën e mbjelljes së farave të imëta.
- Për përdorimin e farërave të grurit të prodhuara dhe të çertifikuara, kryesisht u kemi rekomanduar fermerëve farat e grurit që prodhohen nga Qendra e Transformimit të Teknologjive Bujqësore Lushnje (Q.T.T.B). Në njësitë administrative Tërbuf, Grabjan, Remas, Gradishtë dhe në fshatrat e Bashkisë Divjakë.

Struktura e mbjelljeve për vitin 2024

Emërtimi	Total i (ha)	Kv/ha	Prodhimi (ton)	Divjakë ha	Grabjan ha	Tërbuf ha	Remas ha	Gradish ha
Drithëra	6355		34573.9	911	1254	1691	940	1559
Grure	3348	53	17744.4	540	625	878	485	820
Elb	259	45	1165.5	100	103	2	22	32
Tershere	643	30	1929	71	115	197	113	147
Miser	2105	70	14735	200	411	614	320	560
Perime te	2332		128122	1266	123	650	170	123

para ne fushe								
Laker Koke	108	60	6480	80	3	6	12	7
Lule Laker	83	25	2075	60	4	3	11	5
Qepe e thate	558	72	40176	170	35	275	56	22
Hudher e thate	65	23	1495	10	22	9	13	11
Karrota	65	63	4095	65	0	0	0	0
Brokul	46	16	736	30	2	6	4	4
Shalqi	1201	55	66055	740	35	325	44	57
Pjeper	155	37	5735	100	15	17	15	8
Te tjera	51	25	1275	11	7	9	15	9
MBJELLJE PERIME NE SERA	238.5		19444.5	45	6	15.5	22	150
DOMATE	91.5	900	8235	4	0.5	5	12	70
KASTRAVEC	53	900	4770	6	2	2	2	41
SPECA	35	650	2275	5	0	3	2	25
PATELLXHAN	6.5	700	455	0	0	0.5	0	6
PJEPER	31.5	550	1735.5	17	3	4.5	2	5
SHALQI	21	940	1974	13	0.5	0.5	4	3
Kultura te tjera	1211.5		27450.75	404	227	397.5	83	100
Patate	568	450	25560	360	13	122	51	22
Fasule	176	25	440	40	14	12	32	78
Luledielli	377	32	1206.4	4	148	225	0	0
Bathe industriale	90.5	27	244.35	0	52	38.5	0	0
Foragjere te para	5429		220512	365	705	1307	1312	1740
Jonxhe (e njome)	4660	380	177080	300	675	1290	1195	1200
Miser silazh	389	580	22562	50	6	10	72	251
Laker foragjere	380	550	20900	15	24	7	45	289
Luleshtrydhe	25	30	75	0	20	5	0	0
Bime medicinale	45	20	90	0	0	0	0	45
Peme frutore+vreshta	1181		6495.5	492	96	107	248	238
TOTAL MBJELLE	1681			3483	2431	4173	2775	3955
MBJELLE	7							

Struktura e mbjelljeve të dru fruterëve për vitin 2024 paraqitet si mëposhtë:

DRUFRUTORE (ha)					
Nj.Admin stratve	Gjithsej	Peme	Ullinj	Agrume	Vreshta
DIVJAKE	492	54	343	32	63
TERBUF	107	26	46	5	30
GRABIAN	96	15	60	6	15
GRADISHTE	238	28	140	10	60
REMAS	248	93	127	12	16
TOTAL	1181	216	716	65	184

NË BLEKTORI

Është bërë evidentimi i të gjitha aktiviteteve që operojnë në fushën e bëktorisë, të përpunimit dhe prodhimit të ushqimit me bazë bujqësinë dhe blegtorinë.

Në sektorin e agropërpunimit ushtrojnë veprimtarinë e tyre 87 subjekte nga të cilët:

- linjat e përpunimit të vajit të ullirit 4
- linjat e përpunimit të qumështit (baxho) 10
- linjat të bluarjes së grurit dhe prodhimit të bukës 8
- subjekte që merren me tregtimin dhe përpunimin e mishit 18
- linjat e prodhimit të fidanëve dhe grumbullimit të fruta-perime 12
- subjekte që tregtojnë impute bujqësore 35

Numri i baxhove në Bashkinë Divjakë për vitin 2024

Nr	Njesia Administrative	Nr. i baxhove
1	Divjake	4
2	Terbuf	5
3	Grabian	3
4	Gradishte	1
5	Remas	3
	Total B.Divjake	10

Subjektet që merren me tregtim mishi në Bashkinë Divjakë

Nr	Njesia Administrative	Nr. i subjekteve
1	Divjake	4
2	Terbuf	7
3	Grabian	1
4	Gradishte	4
5	Remas	0
	Total B.Divjake	16

Numri i furrave të bukës dhe vajit të ullirit në Bashkinë Divjakë

Nr	Njesia Administrative	Nr. i Furrave te bukes	Nr. i fabrikave të vajit, të ullirit
1	Divjake	2	1
2	Terbuf	2	0
3	Grabian	1	1

4	Gradishte	3	1
5	Remas	1	1
	Total B.Divjake	9	4

Nr. i subjekteve që tregtojnë fidanë dhe pika grumbullimi në Bashkinë Divjakë

Nr	Njesia Administrative	Tregtim fidanesh	Pika grumbullimi, eksporti
1	Divjake	4	8
2	Terbuf	1	2
3	Grabian	0	1
4	Gradishte	1	5
5	Remas	0	0
	Total B.Divjake	6	16

Nr. i subjekteve që shesin impute bujqësore në Bashkinë Divjakë

Nr	Njesia Administrative	Nr. i subjekteve
1	Divjake	9
2	Terbuf	12
3	Grabian	2
4	Gradishte	9
5	Remas	3
	Total B.Divjake	35

Numri i krerëve të Blektorisë për vitin 2024

Nr	Njesia Administrative	Gjedhe	Te imta	Derra	Shpendë
1	Divjake	1020	2450	620	15000
2	Terbuf	2730	2300	0	25500
3	Grabian	1100	1050	100	4500
4	Gradishte	930	3150	1070	22000
5	Remas	570	3550	50	10200
	Total B.Divjake :	6350	12500	1840	77200

Sipas këtyre të dhënave numri i krerëve të blegtorisë në të gjitha llojet kanë ulje të numrit të krerëve në gjedhë është ulur nga 11,223 krerë nga disa vite më parë në 6,350 ose 44 %, po kështu ka rënie edhe numri i të imtave nga 21,941 krerë ka shkuar në 12,500 krerë ose është ulur me 43 %.

Me rënie janë edhe derrat nga 5,245 krerë në 1,840 krerë ose 65 % rënie.

Po kështu ndodhën edhe shpendët nga 100,600 krerë tani mbarështrohen 77,200 krerë ose 23 % më pak se disa vite më parë.

Kjo tregon rënien e interesit të fermerëve për të mbarështuar blegtori si pasojë e kostos të lartë të prodhimit.

SHËRBIMI VETERINAR

Për periudhën Janar – Prill 2024 shërbimi veterinar pranë Bashkisë Divjakë si objektiv kryesor ka pasur mbajtjen në kontroll të situatës epizotike të kafsheve e shpendëve që mbarështohen në territorin tonë. Ky objektiv është arritur së pari nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme me fermerët që merren me këtë aktivitet, por edhe nëpërmjet bashkëpunimit me hallkat e tjera të shërbimit veterinar rajonal. Një objektiv i rëndësishëm për shërbimin veterinar për vitin 2024 është dhe angazhimi i specialistëve tanë për identifikimin në kohë të rasteve të semundjeve infektive, gripi i shpendëve etj. Në bashkëpunim me shërbimin rajonal veterinar si dhe Policinë Bashkiake është mbajtur nën kontroll tregu i shpendëve të gjalla pranë Bashkisë, duke kontrolluar dokumentacionin përkatës sipas ligjit në fuqi. Kjo është arritur nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme me fermerët në të gjithë territorin e bashkisë, vlerësimin korrekt dhe verifikimin merjthërisht të informacioneve të marra nga fermerë të veçantë për rastet e dyshimta të kësaj sëmundje dhe mbas konfirmimit kemi bërë njoftimin zyrtar të shërbimit veterinar të rrethit mbi bazën e kompetencave që na jep ligji aktual i shërbimit veterinar. si dhe kemi bashkëpunuar ngushtë me shërbimin veterinar të Drejtorisë së Bujqësisë Dushnje për problemin e vaksinimit kundër kësaj sëmundje, proces i cili është në vazhdim për të mos u përsëritur me situata e vitit të kaluar e cila solli pasoja serioze dhe një dëm ekonomik të konsiderueshëm për bashkinë tonë. Pjesë e rëndësishme e punës së shërbimit veterinar për këtë periudhë ka qenë dhe dhënia e informacionit të nevojshëm fermerëve që merren me mbarështimin e blegtorisë për semundjet zoonoze (plasje TBC, brucelozë) për konstatimin e tyre në kohë, por mbi të gjitha për mbrojtjen e shëndetit të vetë fermerëve dhe familjarëve të tyre.

SEKTORI I MJEDISIT

Zyra e mjedisit gjatë periudhës Janar –Prill 2024 është fokusuar në probleme që ndikojnë negativisht në mënyrë të drejtëpërdrejtë në mjedisin nga persona të papërgjegjshëm si dhe nga subjekte private që ushtrojnë aktivitetin e tyre duke mos përmbushur detyrimet ligjore duke u mbështetur në :

- 1.Ligji nr.10431 dt.09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
- 2.Ligji nr.10663 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- 3.Ligji nr.10448 dt.14.07.2011 "Për lejet e mjedisit”.
- 4.Në vendimin e Këshillit Bashkiak për miratimin e tarifave dhe të sanksioneve.
- 5.Me urdhër të lëshuar nga Drejtori i Bujqësisë.

Është ushtruar kontroll në bazë të programit të punës të miratuar nga drejtoria e bujqësisë e konkretisht : Është kryer inspektim i përgjithshëm i territorit. Gjendja rezulton e mirë, por ka vend për përmirësim. Problem mbetet hedhja e mbetjeve jashtë koshave të caktuara për ato nga Bashkia, hedhja e mbetjeve inerte në pikat e miratuara për hedhjen e mbetjeve ushqimore e urbane ku janë mbajtur 50 procesverbale konstatimi sipas ligjit të mbrojtjes së mjedisit. Për të njëjtën mënyrë vepohet për mbetjet organike që dalin nga pastrimi i baxhove, rastet nuk janë të shpeshta, janë raste sporadike. Për të ndihmuar këto subjekte jemi përpjekur të ndërgjegjësojmë qytetarët duke marrë masa konkrete me ta, duke shpërndarë njoftime, nëpërmjet inspektorëve të mjedisit, nxënësve të shkollave si dhe duke nxjerrë njoftime në rrjete sociale.

Njoftimet janë vendosur edhe në njesitë administrative për situatën e mjedisit përsa i përket problemeve që shqetësojnë komunitetin e këtyre zonave. Kemi inspektuar pikat e grumbullimit të perimeve të cilat në përgjithësi nuk kanë probleme. Kemi bërë përpjekje që rrugët të mos ndoten nga mjetet mekanike me dherat e parcelave duke marrë kontakte me drejtuesit e mjeteve. Kemi pasur raste sporadike por jemi përpjekur t'i minimizojmë. Gjatë inspektimeve të vazhdueshme është konstatuar se nxjerrja e plehur organik në rrugë duke zënë hapësirën publike. Jemi përpjekur t'i ndërgjegjësojmë qytetarët e njësive ku sjellja e tyre përbën veprim të kundërligjshëm, duke ndotur mjedisin. Në pjesën më të madhe të rasteve na kanë mrekulluar falë bashkëpunimit me administratorët e kryetarët e fashatrave. Kemi kryer inspektime në shkolla, kopshte, ambulanca, etj, në të gjitha njësitë. Në shkollat qender të bashkisë kemi konstatuar një mjedis të pastr pa asnjë problem. Në shkollat e njësive administrative keni konstatuar probleme të vogla të cilat janë zgjidhur. Në adresë të zyrës sonë kane ardhur gjatë gjithë periudhës rreth 70 ankesa nga qytetarë të ndryshëm. Jemi përpjekur që t'i përgjigjemi në kohë shqetësimeve duke u bërë pjesë e zgjidhjes së problemeve. Në punën tone nuk kemi lënë jashtë vemendjes detyrat që na perkasin në lidhje me mjedisin e plazhit.

Problemet që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme mbeten:

- 1.Mbajtja e blegtorisë brenda zones së banuar ka sjellë një shqetësim të madh për komunitetin ku jetojmë.

2. Të caktohet vendi ku do të derdhen ujërat e zeza që vijnë nga shkarkimi i gropave septike. Kjo përbën shqetësim të madh për gjithë mjedisin e komunitetin e zonave.

SEKTORI I PYJEVE

Gjatë periudhës vitit Janar- Prill 2024 kemi punuar në bashkëpunim me plane pune të miratuar nga Drejtoria për mbrojtjen e fondit pyjor nga prerjet e paligjshme për parandalimin e rënies së zjarreve në fondin pyjor, për zëniet e paligjshme të fondit pyjor dhe për çdo lloj problemi tjetër që bie në kundërshtim me ligjin e pyjeve. Për parandalimin dhe përballimin e dëmeve në pyje kemi patur bashkëpunim me Njësitë Administrative, me Policinë Bashkiake dhe me atë të Rëndit. Përsa i përket prerjeve të paligjshme gjendja e fondit pyjor paraqitet e mire. Deri tani nuk kemi patur raste të zjarreve dhe të kultivimit të kanabisit në fondin pyjor që ka Bashkia Divjakë.

Në si sektor në bashkëpunim me njësitë administrative kemi ushtruar kontrole ditore për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e fondit pyjor. Në këtë drejtim duhet një bashkëpunim më i gjerë si me Policinë Bashkiake edhe me Kryetarët e Fshatrave për ruajtjen e pasurisë pyjore dhe ndërgjegjësimin të popullatës që banojnë në këto zona.

OBJEKTI: SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Sektori i Mzsh-së gjatë këtij 4-mujori Janar-Prill, në të gjithë veprimtarinë e tij është organizuar nga zbatueshmëria e legjislacionit shqiptarë. Gjatë periudhës Janar-Prill 2024, shërbimi i MZSH-së ka miratur 6 leje ndërtimi. Gjatë këtij katër mujori shërbimi i MZSH-së ka vazhduar të kryejë inspektimet për masat e mbrojtjes kundër zjarrit sipas kategorizimit të objekt/aktiviteteve, duke filluar nga ato me rrezikshmëri më të lartë zjarri ku bëjnë pjesë karburantët, pikat e gazit, deri tek ato me pak rrezikshmëri për rënie zjarri, ku janë kryer gjithësej 26 akt kontrole dhe janë lëshuar 14 certifica sigurie për mbrojtjen nga zjarri.

Më shumë prioritet gjatë këtij 4-mujori kemi parë dhe realizuar:

- Forcimin e elementeve të gadishmërisë, të stërvitjes me efektivin, trajnimit dhe kualifikimet e tyre, për të qenë kudoherë vigjilentë dhe të gatshëm në përballimin e situatave të krijuara nga zjarret.

- Shërbimi i MZSH-së është futur në vitin e tetë të aktivitetit të tij, ku në përbërje ka 15 punonjës, ku 2 punonjës janë të nivelit të mesëm Shef Sektori dhe Inspektor parandalimi si dhe 13 punonjës të nivelit bazë që kryejnë shërbimin 24-orarësh, të ndarë në katër grupe me nga tre veta gjatë kryerjes së shërbimit me në krye komandantin e stacionit.

- Shërbimi i MZSH-së është i kompletuar me efektiv luftues, shpëtues, evakues dhe shofer zjarrfikës, për ndërhyrje të ndryshme operacionale. Shërbimi i MZSH-së Divjakë është i kompletuar me dy automjetet zjarrfikëse dhe me shumicën e paisjeve zjarrfikëse, që përdoren në situata të ndryshme.

Shërbimi i MZSH-së Divjakë ka një vlerësim maksimal nga ana e tij, për një regjim gadishmërie të përhershëm, gjithashtu zhvillon një punë të kujdesëshme, për ruajtjen dhe sigurinë të bazës materiale dhe asaj teknike, gjatë përdorimit të zjarre. Kemi zhvilluar prova gadishmërie gjatë këtij katër mujori, duke realizuar të gjitha normat në kohë-përgatitje, ditën dhe natën nga efektivet zjarrfikës. Kemi një efektiv me moshë të re të formuar, stërvitur dhe edukuar me kërkesat maksimale për një motivim të gjithësecilit, për të realizuar detyrat e tyre funksionale. Rëndësi i kemi dhënë marrjes dhe transmetimit në kohën e duhur të sinjalit për një dalje sa më të shpejtë në operacion.

Gjatë këtij 4-mujori Janar-Prill shërbimi zjarrfikës ka kryer 21 dalje operacionale, brenda territorit të Bashkisë dhe jashtë saj, të cilat nuk kanë qenë problematike.

Kërkohet zgjidhje për hapjen e të gjithë rrugëve, në të gjithë zonën e Bashkisë Divjakë, në sistemin e kodrave Shene Premte, Gradishte, sipas programit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, me detyra dhe detyrime për disa drejtori dhe sektorë.



Kemi përpara një situatë të vështirë vere, me situata nga më të ndryshmet, me temperatura të larta. I gjithë efektivi i shërbimit të MZSH-së, do jetë në monitorim dhe kontroll të vazhdueshëm, në të gjithë territorin e Bashkisë Divjakë, për sigurinë, mbrojtjen dhe parandalimin e zjarreve.

Gadishmëria teknike dhe ajo njerzore është primare në të gjithë aktivitetin e këtij shërbimi. Në përgjithësi kjo është teknikë e mirë dhe e mirëmbajtur, e cila kërkon trajtim dhe kujdes, dhe që nuk ka munguar në mundësitë e efektivit zjarrfikës. Shumë materiale konsumohen gjatë veprimtarisë në situatë zjarresh, siç kërkohen edhe materiale të tjera mbrojtëse dhe eficientë për efektivit, që ato të jenë me rezultative në luftime me flaket dhe mbrojtjen e jetës së tyre nga këto rreziqe, e cila është primare.

OBJEKTI: DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Investimet në infrastrukturë dhe projektet urbane ende në proces për vitin 2024:

- **“Blerje çakëll makinerie (SP 1-100mm) per rrugë urbane në Bashkinë Divjakë”**, në vlerën 15 214 863 (dy milion e pesëqind e tetë mijë e treqind) lekë me TVSH, nga ku : 4 613 333 (dy milion e pesëqind mijë) leke pa TVSH nga te ardhurat për vitin 2024 dhe 10 601 530 (tetë mijë e treqind) lekë ,pa TVSH nga granti. - **Në proces tenderimi.**
- **“Blerje binderi për asfaltimin e rrugëve urbane Bashkia Divjakë”**, në vlerën 63 709 480 (dymbëdhjetë milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një presje tetëdhjetë) lekë pa TVSH, nga ku : 8 461 615 leke pa TVSH nga te ardhurat e Bashkisë Divjake dhe 55 279 865 leke pa TVSH nga Granti. . – **Në proces tenderimi.**
- **‘Rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtese anesore dhe ndertim palestre ne Shkollen e Mesme te Bashkuar Remas, Njesia Administrative Remas, Bashkia Divjakë’**, kontratë e lidhur me Nr. 3453/2 Prot, datë 30.04.2024, në vlerë 95 637 472 (nëntëdhjetë e pese milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë me TVSH, nga e cila 76 509 978,42 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e nëntë mijë e nenteqind e shtatëdhjetë e tetë presje dyzetë e dy) leke me TVSH nga buxheti i shtetit, nga te cilat 35 821 030 (tridhjetë e pese milion e teteqind e njeze e nje mije e tidhjetë) lekë me TVSH per vitin 2024, 40 688 948,42 (dyzete milion e gjashtëqind e tetedhjetë e tete mije e nenteqind e dyzete e tete presje dyzete e dy) lekë me TVSH per vitin 2025 dhe 19 127 493,58 (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzete e shtate mije e katerqind e nentedhjetë e tre presje pesëdhjetë e tete) leke me TVSH nga Granti i Bashkisë Divjake per vitin 2024 – – **Në proces**
- **“Rikonstruksioni i shtëpive të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore ”**, kontratë lidhur me Nr.4404/1 Prot., date 30.11.2022 me vlerë 8 309 226 (tetë milion e nëntë mijë e dyqind e njëzetë e gjashtë) lekë me TVSH nga Granti. - **Në proces**

LEJET E NDËRTIMIT TË LËSHUARA NGA D.P.ZH.T PËRGJATË PERIUDHËS KOHORE JANAR-PRILL 2024:

LEJET E LËSHUARA SIPAS LLOJIT	NUMRI TOTAL	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË
Leje Ndërtimi	3	338 258,74 ALL
Leje Rikonstruksioni	2	30 100,00 ALL
Deklarata Paraprake	14	14 000,00 ALL

OBJEKTI: DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I RRUGËVE RURALE

Prioriteti kryesor i punës së Sektorit të Rrugëve për periudhën Janar – Prill 2024 kanë qenë:

- 1- **Mirëmbajtja e sistemit të rrugëve në të gjitha fshatrat e Bashkisë Divjakë.**
- 2- **Mbajtja në gjendje funksionale dhe sistemimi i rrugëve të parcelave.**

Sektori Rrugëve Rurale në Bashkinë Divjakë për periudhën 4 -muajore Janar – Prill 2024, për “Përgatitjen e informacionit për monitorimine Buxhetit për periudhën 4-mujore Janar- Prill 2024 për çdo Sektor dhe Drejtori dhe dërgimi në Drejtorin e Buxhetit dhe Financës” ka përgatitur këtë informacion për realizimin e tregusëve ekonomike-financiare të buxhetit për këtë periudhë si më poshtë:

Drejtoria e Infrastrukturës, Sektori i Rrugëve Rurale në Bashkinë Divjakë ka si prioritet në punën e saj të përditshme sistemimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të parcelave. Për shkak të bujqësisë intensive që zhvillohet në të gjithë territorin administrative të Bashkisë Divjakë dhe si ekonomia kryesore familjare e komunitetit, prej fillimit të vitit 2024, çdo ditë mjetet e Sektorit të rrugëve Rurale kanë punuar për nivelimin, sistemimin e rrugëve të parcelave, pastrimin e kanaleve dhe segmenteve rrugore. Në bazë të planifikimit që bëhet çdo fillim viti pranë kësaj drejtorie edhe për vitin 2024 janë marrë masa për mirëmbajtjen e rrugëve bujqësore dhe prej fillimit të muajit Maj, mjetet e kësaj drejtorie janë duke punuar më intensivisht në drejtira të sistemit dhe nivelimit të rrugëve bujqësore, duke marrë në konsideratë se jemi edhe para fushatës së korres dhe shirje së grurit. Më konkretisht, për periudhën kohore Janar-Prill 2024, duke ju referuar kërkesave të paraqitura nga Administratorët e Njësive Administrative dhe Kryetarët e Fshatrave, është ndërhyrë dhe janë mirëmbajtur ato rrugë bujqësore ku është parë e nevojshme dhe më emergjente të ndërhyhet duke qenë se edhe kushtet atmosferike këtë vit nuk kanë qenë favorizuese për mirëmbajtjen e rrugëve bujqësore. Në Divjakë dhe në zonat e kodrës, është parë më emergjente të bëhet mirëmbajtja e rrugëve bujqësore sepse ka qenë edhe periudha që është bërë vjelja e prodhimeve bujqësore dhe ka qenë më e lehtë për të bërë mirëmbajtjen e këtyre rrugëve nga kushtet atmosferike. Po ashtu, në muajin Maj kemi filluar me sistemimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të Njesisë Administrative Remas dhe Njesisë Administrative Tërbuf. Është duke u punuar intensivisht dhe deri në fillim të periudhës kur nis shirja e grurit do të kenë përfunduar së mirëmbajturi të gjitha segmentet kryesore dhe ato të nevojshme.

SEKTORI I UJITJES DHE KULLIMIT

Sfidat e sektorit ujitje-kullim në këtë 4-mujor kanë qenë shumë të mëdha.

Duke parë investime të konsiderueshme për (vadtjet) që po kryhen në këtë sektor konkretisht në V2,V2-4,V2-7, na ngarkojnë me përgjegjësinë që t'i përgjigjemi me përkushtim implementimit dhe vënies në shërbim të fermerëve të këtij investimi.

Dega e ujitjes gjatë këtij 4-mujori duke patur pritshmëri për rritjen e sipërfaqes së ujitur ka punuar me përkushtim për pastrimin e kanaleve të dyta nga mbetjet bimore dhe dherat që kanë mbatur seksionin e kanaleve ujitës, konkretisht :

Janë pastruar me mjete eskavatorë këta kanale ujitës:

1-Kanali ujitës Divjakë-Xeng	1,5 km
2-Kanali ujitës V2 Zharnec	0,8 km
3-Kanali ujitës sekondar V2/1 Gradishtë	0,9 km
4-Kanal ujitës sekondar V24/7 Babunjë	1 km
5-Kanal ujitës sekondar Gorica	1 km
6-Kanal ujitës sekondar Këmishtaj	1.2km
7-Kanal ujitës sekondar Senez	0.8 km
8-Kanal ujitës sekondar Gur	2.3 km
9-Kanal ujitës sekondar V2-7/3	1.1 km
TOTAL	10.7 km

Në këtë sektor nga detyrat e lëna janë realizuar:

Krahas pastrimit të kanaleve sekondar ujitës me një gjatësi 10.7 km me mjete mekanike, janë pastruar gjithashtu edhe me punëtorë një gjatësi prej 1.5km kanale ujitës sekondarë dhe terciare.

Gjithashtu janë betonuar dhe riparuar nga vetë sektori ynë edhe Barazhi i Grabjanit, betonuar fugat në një gjatësi prej 700ml në Kanalin ujitës V2-7 në fshatin Gurë dhe një gjatësi prej 20ml, në fshatin Këmishtaj, janë vendosur tubo dhe tombino për të rritur sipërfaqen e ujitjes.

Detyrat e lëna:

1.Rritja e gadishmërisë të rrjetit ujitës për çdo Nj.Adm.

2-Pastrimi i kanaleve ujitës sekondarë që kanë grafikun e pastrimit sipas prioritetëve të parashikuar nga dega teknike.

3-Ndjekja me përgjegjësi dhe përpikëmbëri e ujit gjatë sezonit të ujitjes nga mjeshtrat e ujit, në mënyrë që asnjë pikë uji të mos shkojë dëm, dhe të ndiqet grafiku i fermerëve me korrektësi për ujitjen në kohë të bimësisë të fermerëve.

3-Parandalimi i fatëkeqësive natyrore si përmbytjet nga rreshjet ose nga difektet që mund të ndodhin gjatë sezonit të ujitjes, bllokime apo gadishmëria e digave të rezervuarëve që ndodhen në territorin e bashkisë dhe që janë amortizuar si pasojë e jetëgjatësisë së lartë që kanë.

Dega e kullimit

Gjatë këtij katërmujori Dega Teknike e Sektorit Ujitje-Kullimit në bashkëpunim me Sektorin e Rrugëve ka punuar me përkushtim për të venë në efikasitet mjeteve e rënda që sektori ynë ka në dispozicion duke i mbajtur ato në gadishmëri e në gjëndje të mirë teknike.

Gjate këtij 4-mujori janë pastruar :

1-Dk3-2-5	Divjakeë	1km
2-Dk3-2-4	Divjakë	0.2 km
3-Dk3-5	Xeng	1.3km
4-DK3-6	Xeng	0.65km
5-Dk3-2	Divjakë	1.2 km
6-Dk3-3-1	Divjakë	0.5 km



7-Dk3-1	Divjakë	1.6 km
8-Dk3-3-5	Divjakë	0.8 km
9-dK3-4	Divjakë	0.9 km
10-Dk3-4-11	Babunjë	0.8 km
11-Dk10-9	Ferras	1.1 km
12-Dk-2-1	Çermë e Sipërme	1.1 km
13-Kolektori	Gramsh - Bicukas	4.4 km
TOTALI		15.55 km

Detyrat e lëna :

- 1-Në qendër të vëmendjes për këtë sektor do të jëtë bashkëpunimi me firmën kontraktuese për hartimin me përpikëmeri të projekteve të kanaleve kullues që do të pastrohen në vijim.
- 2- Ndjekja në terren e punës, kontrolli i vazhdueshëm i mjeteve të rënda, zbatimi i ararit dhe i kushteve teknike
- 3-Bashkëpunimi, bashkëveprimi dhe koordinimi i punëve i Degës së Kullimit me Degën e Ujitjes dhe me sektorë të tjerë të drejtorisë dhe të bashkisë.

OBJEKTI: SEKTORI I MIRËQËNIES SOCIALE DHE PËRKUJDESIT SHOQËROR

1-PERSONT PAK QE TRAJTOHEM ME PAGESEN E INVALIDITETIT

Ne baze të Ligjit Nr.57/2019 date 18.02.2019 “PËR ASISTENCËN SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” neni 31 si dhe në zbatimin të VKM Nr.618, date 07.09.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së përfitimit të pageses për personat me aftësi të kufizuara”

Ne Bashkinë Divjake kemi 1650 Invalide që trajtohen me pagese të përfitimit të Kempit në baze të vendimeve të KMCAP-it sipas ligjit në fuqi.

Identifikojmë Personat me Aftësi të Kufizuar dhe I ndihmojmë për përgatitjen e dokumentacioneve për përfitimin e pageses së PAK.

Personat që duan të komisionohen paraqesin tek në dokumentacionet e kërkuar sipas legjislacionit.

I bëjmë vlerësimin social-ekonomik të familjes që kanë personat me aftësi të kufizuara.

I dergojmë me proces verbal pranë mjekut të Drejtorisë Rajonale të Sherbimit Shtetëror listen e personave që komisionohen për herë të parë dhe ata që do rikomisionohen dy muaj para afatit të bashku me dokumentacionin përkatës si dhe I njoftojmë personat për vendimin e komisionit.

Hartojmë Listpagesen bordorot me listen e personave me aftësi të kufizuar për marrjen e pagese që ju takon sipas ligjit.

Administrojmë dosjet e PAK në të cilën ndodhet kopje e vendimet të KMCAP-it për secilin përfitues kjo e marrë nga mjeku i Drejtorisë Rajonale.

2- NDIHMA EKONOMIKE

Ne baze të Ligjit Nr.57/2019 date 18.02.2019 “PËR ASISTENCËN SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” dhe VKM Nr 597 date 4.9.2019 “ Për përcaktimin e procedurave si dhe dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmes ekonomike:

Ne Bashkinë Divjake në 5 njesite administrative të saj përfituese të ndihmes ekonomike janë rreth 150 familje që përfitojnë pagesen e ndihmes ekonomike.

Për shkak të hyrjes së Ligjit të ri 57/2019 për Asistencë Sociale dhe Udhëzimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Sherbimit Socialë Shtetërorë Ndihma Ekonomike që nga Muaji Gusht 2019 nuk kalon më nepermjet miratimit nga Keshilli Bashkiak dhe fituesit përzgjidhen nga sistemi i pikezimit me miratim Vendimi nga Drejtoria Rajonale e Sherbimit Socialë Fier.

Për tju ardhur sa më shumë në nevojë njërezve në gjendje të vështirë ekonomike Bashkia Divjake për 8 familje ka dhënë ndihmë të menjehershme financiare nga të ardhurat e veta në vlerë 270.000 mijë lek.

Per familjet ne gjendje shum te keqe, grate e ndara dhe Femijet jetim ne veshtires ekonomike kemi ndare ndihma ne intervale kohe te ndryshme si pako si veshmbathje batanije dhe ndihma ushqime.

1.Presim familjet ne nevoje dhe bejme aplikim ne sistem, kjo behet cdo 10 dite te fillimit te muajit.

2.Bejme verifikim dhe vizita ne familjet qe kane aplikuar dhe jane ne skemën e Ndhmes Ekonomike.

3.Plotesojme Projekt Vendimin dhe i propozojme Drejtorise se Sherbimit Sociale per perzgjedhjen per perfitues nga lista e aplikimeve .

4. Propozojme per ato familje qe nuk kane dal perfituese nga sistemi I pikezmit te ndimohen nga bllok ndihma 6% per nje periudhe te caktuar kohore

5-Bejme projekt vendim dhe Vendim per familjet qe jan perfitues nga fondi 6%.

3-BLOK NDIHMA EKONOMIKE 6%

Ligji Nr 57/2019 “PER ASISTENCEN SOCIALE “ dhe VKM Nr 597 date 4.9.2019 “ Per percaktimin e procedurave si dhe dokumentacionit dhe te mases majore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike” Kreni IV pika 2 dhe ne zbatim te Udhhezimit Nr 5 date 17.02.2017 “Mbi perdorimin e fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike deri ne 6% ,

Ne baze te aplikimeve qe familjet ne nevoje qe kan bere dhe qe nuk kan dal perfituese nga sistemi i perzgjedhjes i pikezimit ne si Sektor I Mirqenies Sociale jemi munduar keto familje ti ndimejme duke i futur ne ndihme ekonomike ne fondin 6% duke bere verifikimet e nevojshme dhe duke plotesuar kriteret e vendosura ne ligj.

Pra cdo fillim viti mbas miratimit te kriterave ne Keshill Bashkiak per familjet qe do trajtohem me ndihmen ekonomike nga fondi I kushtezuar deri ne 6% .

Ne skemen e 6% kemi futur dhe ndihmuare rreth 20 familje me nje vlere totale 329.454 leke.

4-NJESIA PER MBROTJEN E FEMIJEVE

Ne Baze te Ligjit 18/2017 “Per te Drejtat dhe Mbrotjen e Femijeve” eshte detyrim ligjor per cdo Bashki te ketë specialiste per Mbrotjen e Femijeve.

Gjate ketyre muajeve kemi pasur 5 raste te menaxhuare femijesh qe jan ndihmuare per situatat e tyre dhe problematikave te veshtira qe kan pasur.

Per rastet emergjente me problematike dhunen fizike apo seksuale eshte kerkuar strehim emergjente ne institucione rezidenciale per keto kategori dhe pergatitja e dokumentave sipas ligjit per ne Gjykate per kerkimin vlershmerin e vendimev te Pergjegjesite te Sektorit te Mirqenies Sociale duke qene dhe pergjegjesi I NJMF ai ka te drejt te marri Vendim per zgjidhjen e situates sipas Ligjit 18/2017.

Eshte bere ne Gjykate kerkesa per marrje Kujdestarie kur Bashkia ka qene si pale e trete dhe ka dhene informacion dhe dokumentacionin e kerkuar nga Gjykata per femijen apo biresuesin e tij qe duhet te jete i afermi I femijes per marrjen e kujdeestaris sipas nenve e ligjit.

1.Monitorojme situaten te familjeve te femijeve ne rrezik, derisa femija mos te konsiderohet jo ne rrezik.

Bejme proceduren vlersimin social ekonomike te femijes dhe familjes dhe referojme rastet ne institucionet e duhura dhe ne NJ.M.F e Bashkie te tjera nese nuk jane banore te bashkise sone. Plotesojme dokumantacionin dhe ja paraqesim keshillit bashkiak kur na kerkohet nga familja ku kane femije me aftesi ndryshe per ti akomoduare ne qendra me sherbim te vecante perkujdesje. I cojme informacion dhe raportim tek ASHMF

5-DHUNA NE FAMILJE DHE BARAZIA GJINORE

Ne baze te Ligjit 47/2018 “Per masat ndaj Dhunes ne marrdheniet familjare”

si dhe VKM Nr. 334 date 17.2.2011 “Per Mekanizmin e Bashkerendimit te Punes per Referimin

Qe nga Muaji Tetor 2019 kemi nje Specialiste qe merrte me Dhunen ne Familje dhe Brazine Gjimore, Merremi me raste te Viktimave te Dhunes ne mardheniet familjare duke i regjistruare ne sistemin **Revalb** qe sipas ligjit nr.9969,dt.18.12.2006” per masat ndaj dhunes ne mardheniet familjare. te cilat jane leshuar urdher mbrojtje me vendim te gjykates



OBJEKTI: DREJTORIA E KULTURËS, SPORTIT, TURIZMIT DHE ARSIMIT

Gjatë kësaj periudhe janë kryer disa aktivitete kulturore:

Drejtoria e Kulturës, Sportit, Turizmit dhe Arsimit duke filluar nga muaji Janar deri në muajin Prill ka kryer këto aktivitete.

SEKTORI KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

20.01.2024 - Festa e qytetit.

Për festën e qytetit u zhvilluan aktivitete të ndryshme në qendër të qytetit, të cilit ju bashkuan edhe nxënësit e shkollave të ZVAP-Divjakës.

07-08-09.02.2024 - U zhvilluan veprimtari të ndryshme kulturore artistike, nxënësit e shkollave të ZVAP-Divjakës morrën pjesë në cirkun e Gjirokastrës në mjedisin e shkollave si edhe në qendrën kulturore të qytetit.

29.02.2024 - U zhvillua kampionati i shahut midis shkollave 9-vjeçare të ZVAP-Divjakës.

05.03.2024 - Shfaqje për fëmijë tek qendra e kulturës.

07.03.2024 - 08.03.2024 - U zhvillua aktiviteti festiv dedikuar festave ku nxënësit kishin përgatitur këngë e poezi etj.

14.04.2024 - U zhvillua aktiviteti Trofeu Enduro 2024 (gara me motorra) në zonën e plazhit të Divjakës.

23.04.2024 - Dita botërore e librit "instalacion artistik". Drejtoria e Kulturës organizoi aktivitet me nxënësit e shkollave ku secili prej tyre lexoi thënie e poezi nga libra të autorëve të ndryshëm.

24.04.2024 - 25.04.2024 - U zhvillua kampionati i futbollit midis shkollave të ZVAP-Divjakës. Gjithashtu në datë **29.04.2024** u zhvillua gjysëm finalja dhe në datë **30.04.2024** finalja e kampionatit.

Plani sportiv Janar-Prill 2024

KS ARNISA U11

1.Ditët/Oraret e stërvitjes gjatë periudhës Janar-Prill

E Martë

E Enjte

15:30

15:30

Seancat stërvitore zgjasin deri në orën 17:30

2.Ndeshjet në fundjavë

Janar

22.01.2024 KF Tomori U11 – KS Arnisa U11 1-1

27.01.2024 KS Arnisa U11 – KS Lushnja U11 4-1

Shkurt

07.02.2024 KS Lushnja U11- KS Arnisa U11 1-2

25.02.2024 KF Ylberi U11 – KS Arnisa U11 1-1

Mars

10.03.2024 KS Arnisa U11- KS Lushnja U11 2-4

17.03.2024 KF Jeku D U11 – KS Arnisa U11 2-2

24.03.2024 KS Arnisa U11 – KF Tormori U11 5-2

31.03.2024 KS Arnisa U11 – KF Ylberi U11 4-2

Prill

Ndeshje miqësore midis skuadrave të Arnisës në të cyja grupmoshat U11 dhe U13

Lojrat me dore për periudhën Janar – Prill 2024.

1.Gjatë muajit Janar jemi marrë me përgatitjen stërvitore të vajzave për vazhdimin e kampionit kombëtar të volejbollit. Çdo të hënë, të mërkurë, dhe të premte.



2. Në muajin shkurt kemi rifilluar kampionatin kombëtar të volejbollit, ku jemi ndeshur me ekipet, Erzeni, Club Albania, MSD (Mjeshtria Sportive Durrës) të cilat janë zhvilluar brenda dhe jashtë Divjakës.
3. Gjithashtu kemi vazhduar stërvitjen në ditët e caktuara dhe ditën e shturë zhvillimin e ndeshjes për kampionatin.
4. Në muajin Mars kemi vazhduar përsëri me përgatitjen stërvitore për ndeshjet e radhës me Apolloninë dhe Flamurtarin. Dhe në përfundim të kampionatit kemi bërë analizën e përgjithshme të ndeshjeve të kampionatit.
5. Gjatë muajit Prill pas përfundimit të kampionatit filluam regjistrimet për moshat e vogla nga moshë 10-14 vjeç dhe deri më tani janë regjistruar 20 vajza të reja. Gjatë këtij muaji gjithashtu kemi vazhduar stërvitjen si normalisht me të dyja grupmoshat (të mëdhenj dhe të vegjël), në ditët e caktuara dhe orare të ndryshme.

SEKTORI I TURIZMIT

Turizmi në Bashkinë Divjakë shihet si një ndër sektorët prioritar, pasi potenciali që ka Qyteti i Divjakës përse i përket turizmit është shumë i lartë, Bashkia Divjakë në vitet e fundit ka përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën përse i përket turizmit, duke e bërë Divjakën një ndër atraksionet më interesante për të vizituar.

Në hyrje të pyllit të Divjakës Bashkia Divjakë ka vendosur në dispozicion disa varka të cilat shërbejnë për të bërë shëtitje në lagunë dhe për ta shijuar mrekullinë e natyrës nga afër.

Nga bashkia Divjakë është bërë investimi për ndërtimin e Godullës së Brendëshme e cila i ofron vizitorëve një shëtitje në pyllin me pisha deri tek Kulla 360° e cila është një investim tjetër i Bashkisë Divjakë ku vizitorët nëpërmjet një pagese simbolike prej 100 lekësh mund të hyjnë dhe nga ajo të shijojnë pamjen e qytetit të divjakës dhe lagunës në këndin 360°.

Duke qënë se Qyteti i Divjakës është një ndër atraksionet me më shumë interes për të vizituar, turizmi shihet edhe si një burim të ardhurash, edhe pse tarifat e shërbimeve të ofruara janë vendosur në shifra simbolike në mënyrë që çdo individ pavarësisht mundësive ekonomike të ketë mundësi të shijojë bukuritë e Divjakës. Gjatë periudhës Janar-Prill 2024 vizitorët i kanë sjellë të ardhura Bashkisë Divjakë 1,324 mijë lekë. Këtë periudhë u numëruan 72 mijë turistë vendas dhe 23 mijë turistë të huaj.

1. Kulla 628 mijë lekë
2. Varka 632 mijë lekë
3. Evente 64 mijë lekë
4. Totali 1,324 mijë lekë

SEKTORI I ARSIMIT

Zyra për arsimin, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Finances ka rritur efektivitetin e pagesave të mësuesve të arsimit bazë dhe punonjëseve mbështetës duke bërë të mundur bërjen e pagesave më shpejtë në kohë. Për periudhën Janar – Prill 2024 mësuesit e arsimit bazë të cilët paguheshin nga Bashkia Divjakë janë mesatarisht 70 punonjës.

Në Bashkinë Divjakë gjithashtu funksionojnë dhe 2 kopshte me drekë. Kopshti i Divjakës me drekë frekuentohet nga 160 fëmijë nga të cilët 70 fëmijë konsumojnë drekën. Të ardhurat të cilat janë planifikuar të realizohen nga përdorimi i shërbimit të drekës në Kopshtin e Divjakës janë 834,450 lekë dhe arkitime të kryera për periudhën Janar -Prill 2024 janë 787,350 lekë. Kopshti i Çermë Sektorit, Njad. Tërbuf frekuentohet nga 111 fëmijë nga të cilët 20 fëmijë konsumojnë drekën. Sipas të dhënave nga Kopshti Çermë Sektor, Njad. Tërbuf të ardhurat të cilat janë planifikuar të realizohen nga përdorimi i shërbimit të drekës 214,200 lekë dhe arkitimet të kryera për periudhën Janar – Prill 2024 janë në vlerën 148,800 lekë.

SHPENZIMET E ARSIMIT PARASHKOLLOR DHE ARSIMIT BAZË JANAR- PRILL 2024 (NË MIJË LEKË)

SHK. 000-000-000

Artikulli	Emërtimi	Shpenzimet	
		Plani	Fakti
600	Shpenzime për paga	25,475	16,930
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,660	2,815
602-604	Mallra dhe shërbime të tjera	6,030	1,702
231	Investime	1,050	0
	Shuma :	36,215	21,488

Ndërsa punonjësit mbështetës të Arsimit të Mesëm të cilët paguhën nga Bashkia Divjakë janë mesatarisht 2 punonjës.

SHPENZIMET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR JANAR – PRILL 2024 (NË MIJË LEKË)

Artikulli	Emërtimi	Shpenzimet	
		Plan	Fakti
600	Shpenzime për paga	426	382
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	73	64
602	Mallra dhe shërbime të tjera	681	0
231	Investime	7,734	
	Shuma :	8,914	446

OBJEKTI: SEKTORI JURIDIK, PROKURIMEVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

